



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:244887
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05236177

AC-I-23-0056

Në ankesën e

Paditësi

I P, fshati P, Komuna e Vitisë.

kundër

E paditura/Ankuesja

NSH.N.B.I. "Agromorava", (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtarë duke vendosur sipas ankesës e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6740 të datës 12 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-6740 i datës 12 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 27 tetor 2014, paditësi e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, GJI035-0116, të datës 01 tetor 2014, me të cilin kërkesa e paditësit e datës 26 gusht 2014, për kompensimin e 3 pagave të pa paguara në shumë prej 600,00 euro refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pastaj kundër vendimit GJI035-0114 të datës 01 tetor 2014, me të cilin kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, si dhe kundër Vendimit, GJI035-0115 të datës 03 tetor 2014, me të cilin kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 01.01.2004-31.12.2010, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Në ankesë paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke pohuar se ka paraqitur kërkesën në afatin e duhur ligjor, dhe se atij i takojnë tri paga në shumë prej 600,00 euro, pastaj 1,200.00 euro në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, si dhe 2,717.00 euro në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga 01.01.2004 e deri me 31.12.2010. Tuje në ankesë ai pohon se për shkak të privatizimit të NSH-së me datë 24 dhjetor 2007, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës, duke pohuar se ka pranuar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ai pohon se në bazë të këtij njoftimi është paraqitur me tri kërkesat pranë Autoritetit të Likuidimit, të cilat pa ndonjë bazë ligjore janë refuzuar si të pavlefshme. Me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI035-0116 të datës 01 tetor 2014, GJI035-0114 të datës 01 tetor 2014, GJI035-0115 të datës 03 tetor 2014, kopjen e Kontratës së punës të datës 28 shtator 2007, një Specifikacion mbi obligimet e pa paguara, kopjen e Listës përfundimtare për të drejtën për 20%, një Procesverbal të Bordit të NSH-së, Një konfirmim të Policisë së Kosovës për zjarrvënje në objektet e NSH-së, Kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 24 dhjetor 2007, si dhe kopjen e Letërnjoftimit.

Me datë 07 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje

AKP-ja ka pohuar se paditësja ka dështuar të tregoj se cili nen i Ligjit të AKP-së, është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe në këtë mënyrë është shkelur neni 74.2 i LDHP-së. Po ashtu AKP-ja ka pohuar se kërkesa për 3 paga të pa paguara, kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe kërkesa për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën 01.01.2004 deri me 31.12.2010 janë parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk i ka paraqitur këto kërkesa në gjykatën kompetente brenda tri viteve.

Me datë 12 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6740, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, dhe i ndryshon vendimet e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, GJI035-0114 të datës 01.10.2014, dhe GJI035-0115 të datës 03.10.2014, si dhe e obligoj AKP-në që ti paguaj paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shume prej 1.200.00 euro, dhe në emër të pagave të pa paguara të paguaj shumen prej 2,717.00 euro, ose gjithsej për dy kërkesat shumen prej 3,917.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shume prej 391.70 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS me piken e **II-të** të dispozitivit të Aktgjykimit, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj, vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI035-0116 të datës 01.10.2014, i cili vendim i përket tri pagave të fundit të pa paguara, në shume prej 600.00 euro.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk është kontestues fakti se paditësi ishte punëtor i NSH-së deri me datë 24 dhjetor 2007, kur atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit të NSH "Agromorava" në Viti. Në bazë të njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës është parapare që shumat-pagat që janë mbetur borxh sipas kontratës së punësimit do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Njoftimi për ndërprerjeje të marrëdhënies së punës i datës 24 dhjetor 2007, ka prodhuar efekt juridik si për paditësin ashtu edhe për NSH-në sa i përket marrëdhënies së punës, pasi që ky njoftim e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesave. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka konstatuar se me Specifikacion mbi obligimet e pa paguara, të lëshuar nga ana e NSH-së, vërtetohet se paditësit NSH-ja i ka borxh lidhur me pagat e periudhës 01.01.2004 e deri me 31.12.2010, në shume prej 2.717.00 euro. Tutje

Shkalla e I-rë konstaton se me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës me datë 24 dhjetor 2007, vërtetohet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit të NSH-së. Andaj duke u bazuar në këto prova paditësit i është njohur e drejta e kompensimit në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shume prej 1,200 euro, dhe në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën e cekur në shume prej 2,717.00 euro, ose për 2 kërkesat në shumën totale prej 3,917.00 euro, si dhe interesin ligjor prej 10% në shume prej 391.70 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ankesën që ndërlidhet me kërkesën për tri paga të fundit të papaguara në shumë prej 600.00 euro e refuzon si të pa bazuar, duke konsideruar se kërkesa është parashkruar.

Me datë 02 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzon një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-14-6740, të datës 12 janar 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të refuzohet padia si e pa bazuar. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë, është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar- afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për pagesën e tri pagave të papaguara, kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara në periudhën e cekur, është dashtë të paraqiten brenda 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, ndërsa kërkesat janë paraqitur nga paditësi tek Autoriteti i Likuidimit me 26 gusht 2014, andaj këto kërkesa janë parashkruar.

Me datë 12 prill 2023, paditësi e ka dorëzuar një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së, dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të

Shkallës së I-rë të DHPGJS-së. Tutje paditësi pohon se të tri vendimet e ankimuara nga ana e tij të Autoritetit të Likuidimit janë të pa bazuara në Ligj, meqë kërkesat e tij të paraqitura tek Autoriteti i Likuidimit, nuk janë parashkruar siç pretendon në mënyrë të gabuar AKP-ja.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 26 gusht 2014, i ka dorëzuar tri kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit, kërkesën për pagesën e 3 pagave të fundit të papaguara në shumë prej 600,00 euro, kërkesën për kompensim të ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shume prej 1.200.00 euro, si dhe kërkesën për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën nga data 01.01.2004-31.12.2010, në shume prej 2,717.00 euro. Këto tri kërkesa janë refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit duke e ndryshuar dy vendimet e Autoritetit të Likuidimit GJI035-0114 të datës 01.10.2014 që i përket kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, dhe vendimin GJI035-0115 të datës 03 tetor 2014 që i përket kërkesës për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën 01.01.2004-31.12.2010, duke mos u pajtuar me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se këto dy kërkesa janë parashkruar.

Tutje Shkalla e I-rë me pikën **II** të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar e ka refuzuar kërkesën për tri paga të fundit të pa paguara prej 600 euro, dhe e ka vërtetuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj, vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI035-0116 të datës 01 tetor 2014, duke u pajtuar se kjo kërkesë është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesë ka sjell dëshmitë vijuese: Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI035-0116 të datës 01 tetor 2014, GJI035-0114 të datës 01 tetor 2014, GJI035-0115 të datës 03 tetor 2014, kopjen e Kontratës së punës të datës 28 shtator 2007, një Specifikacion mbi obligimet e pa paguara, kopjen e Listës përfundimtare për të drejtën për 20%, një Procesverbal të Bordit të NSH-së, Një konfirmim të Policisë së Kosovës për zjarrvënie në objektet e NSH-së, Kopjen e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 24 dhjetor 2007, si dhe kopjen e Letërjnjoftimit.

Nga provat e cekura më lartë, është e qartë se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit të NSH-së që ka ndodh me datë 24 dhjetor 2007.

Paditësi në bazë të njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 24 dhjetor 2007 ka dëshmuar se atij me veprimin e AKM-së, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të privatizimit të NSH-së.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shume prej 1.200.00 euro, nuk është kontestuar shprehimisht nga ana e AKP-së në mbrojtjen në ankesë, natyrisht përveç parashkrimit, andaj duke u bazuar në këtë fakt, Kolegji i Apelit e mbështet Aktgjykimin e ankimuar lidhur me këtë kërkesë të paditësit, si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit me ankesën e tij kërkon edhe paga të pa paguara për periudhën 01.01.2004 e deri me 31.12.2010, në shume prej 2,717.00 euro, që do të thotë ai kërkon të njëjtën shume siç ceket në specifikacionin mbi obligimet e pa kryera të lëshuara nga ana e NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies se punës, NSH-ja është privatizuar me 24 dhjetor 2007. Andaj pagat e kërkuara nga paditësit pas kësaj periudhe, do të thotë nga muaji janar 2008 e deri në dhjetor 2010, nuk mund të jenë përgjegjësi e NSH-së, meqë në dhjetor 2010 NSH-ja më nuk ka mund të ekzistonte, meqë ajo ishte e privatizuar me datë 24 dhjetor 2007. Këtë pjese të kërkesës për paga, Shkalla e I-rë e DHPGJS nuk e ka trajtuar, ose si duket nuk e ka vërejtur këtë fakt.

Megjithatë duke marrë për bazë faktin se shuma prej 2,717.00 euro e kërkuar nga paditësi në emër të paga të pa paguara, është edhe shumë monetare që ceket edhe në Specifikacion mbi obligimet e pa paguara, i cili Specifikacion është lëshuar dhe vulosur nga Drejtori i NSH-së, e duke marrë për bazë edhe faktin, se lartësia e kërkesës lidhur me pagat e pa paguara nga ana e NSH-së, për periudhën e cekur, përveç parashkrimit, nuk kontestohet shprehimisht nga ana e AKP-së, as me mbrojtjen në ankesë në Shkallen e I-rë, dhe as me ankesën e saj në Shkallen e dytë, andaj nga këto arsye, e duke u bazuar në këto dy fakte, Kolegji i Apelit e mbështet Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës se I-rë se shumatat e aprovuara në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës se punës, dhe në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën e cekur, si dhe në emër të interesit ligjor, duhet të paguhen sipas prioriteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se pika **II** e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për tri paga të fundit të pa paguara, nuk është ankimuar me ankesë nga ana e paditësit, dhe as AKP-ja këtë pjesë nuk e kundërshton, andaj pjesa refuzuese e Aktgjykimit, nuk do të jete subjekt i vlerësimit ligjor nga ana e Kolegjit të Apelit.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i animuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesja tashme e ka paguar taksen gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 21 shkurt 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____

Numri i lëndës: 2022:244887
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05236177